

ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

V. Shënime Mbi Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ZICO" SHA është krijuar juridiksht me vendimin e Gjykatës nr. 34285 ,date 04.11.2005 si dhe është regjistruar në QKB më datën 04.11.2005.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Vaqarr, Tirane.

NIPT-i i Shoqërisë është K61812006M. Administratori i Shoqërisë është z.Trifon Murataj.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është importi, eksporti dhe tregtimi i produkteve ushqimore, kryesisht banane, mish i ngrirë dhe produkte të tjera. Shoqëria është një shoqëri aksionere me një kapital prej 24,000,000 Lekë i ndarë në 2,000 aksione me vlerë nominale prej 12,000 Lekë.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet:

- | | |
|------------------------|---------|
| 1. Anastas Kriqi | Kryetar |
| 2. Desantila Prrenjasi | Anëtar |
| 3. Petrit Demishaj | Anëtar |

Numri mesatar i të punëuarve nga 01.01.2019 deri më 31.12.2019 është 126 punonjës.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 "Pasqyra e Lëvizjes së Parasë"**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

2.2. Standardet dhe interpretimet e emetuara që futen në fuqi më 01 Janar 2018

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- **SNRF 9 "Instrumentet financiare"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 Janar 2018),
- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),



- **Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione"**, - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë)
- **Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara"** - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).
- **KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Standardet dhe interpretimet e emetuara që futen por ende të pa përvetësuar

- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"**- interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019),

Shoqëria ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve dhe ndryshimet në standardet ekzistuese nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqëria.



3. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të mëposhtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet përkatësisht.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Lek.

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar. Për vitin 2018 dhe për vitin 2019 ZICO SHA është në vijimësi të biznesit.

3.3. Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive



ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e pasqyrave financiare. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kurset e Këmbimit	31.12.2019	31.12.2018
Euro/Leke	121.77	123.42
USD/Leke	108.64	107.82
GBP/Leke	143	137.42
CHF/Leke	112.3	109.6

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.



ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parës, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit si edhe investime të tjera tejet likuide.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parës të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivët financiarë të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale të aksioneve

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur koston e tyre historike dhe perfshirjen e të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike.

4.4. Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin(+/-) dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i Aktiveve Afatgjata llogaritet sipas normave të amortizimit Fiskal,

Amortizimi i vlerësuar për vitin 2018 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Amortizimi
Ndërtesa	5%, Mbi Vlerën e Mbetur
Kompjutere, Software etj	25%, Mbi Vlerën e Mbetur
Makineri dhe pajisje	20%, Mbi Vlerën e Mbetur
Aktivet e Pa Trupezuara	15%, Linear
Te Tjera	20%, Mbi Vlerën e Mbetur

Keto metoda amortizimi zbatohen për asetet e ZICO SHA.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.



ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrrat financiare për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndertesa	Aktive Jo Materiale	Ndertime & Instalime	Makinieri dhe pajisje	Mjete Transporti	Pajisje informatike	Ndertime Ne Proses	Total
Vlera bruto e AAM me 31.12.2018	48,250,300	-	6,921,180	-	16,500,658	37,713,714	3,651,163	239,426,362	352,463,377
Shtesa gjate 2019	8,162,610	11,786,080	-	-	7,106,204	35,309,798	395,825	124,409,003	187,169,520
Pakesime	-	-	-	-	-	(531,800)	-	(339,750)	(871,550)
Vlera bruto e AAM me 31.12.2019	56,412,910	11,786,080	6,921,180	-	23,606,861	72,491,712	4,046,988	363,495,615	538,761,347
Amortizimi i akumuluar 31.12.2018	-	-	2,076,354	-	9,293,273	24,698,191	1,983,866	-	38,051,684
Pakesime	-	-	-	-	-	(497,658)	-	-	(497,658)
Amortizimi i vitit 2019	-	-	1,038,177	-	1,811,759	7,200,413	401,074	-	10,451,423
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2019	-	-	3,114,531	-	11,105,032	31,400,946	2,384,940	-	48,005,448
Vlera neto e AAM 2019	56,412,910	11,786,080	3,806,649	-	12,501,829	41,090,767	1,662,049	363,495,615	490,755,899
Vlera neto e AAM 2018	48,250,300	-	4,844,826	-	7,207,385	13,015,523	1,667,297	239,426,362	314,411,694

Për te gjithë aktivet shoqeria ZICO SHA amortizimin e llogarit sipas normave fiskale.



ZICO SHA viti 2018*(Vlerat janë në Lek)***6. Inventarë**

Balancat e inventarit më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshte:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Mallra ne Magazine	284,651,147	277,901,808
Mallra ne Magazine Doganore	<u>116,628,501</u>	<u>108,204,475</u>
TOTALI	401,279,648	386,106,283

7. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Llogari te arketueshme tregtare	174,813,963	107,613,170

Llogari te tjera te arketueshme	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
TVSH Kreditore	119,168,582	117,347,197
Gjendje Debitore ne Dogane	1,756,435	1,448,611
Parapagime te dhena	1,001,707	6,472,500
Ceshtje ne gjykim per Rivleresim Doganor	429,632	429,632
Shteti detyrime per kontrollin tatimor (PROCES GJYQESOR)	17,726,267	-
Garanci bankare per sanksionin e DPD per praktikat doganore	317,984	-
Dentim malli 2 cntr Hapag Lloyd	3,136,536	-
Dhene borxh per punonjesit	4,899,188	-
Garanci bankare per pullat fiskale	<u>527,175</u>	<u>-</u>
	148,963,506	125,697,940

8. Shpenzime për të shpërndarë

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Shpenzime te Shtyra	-	-
	-	-

9. Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Mjete Monetare ne Banke	33,905,241	16,210,640
Mjete Monetare ne Arke	<u>5,384,076</u>	<u>3,160,408</u>
	39,289,316	19,371,048



10. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 24,000,000 Lekë i ndarë në 2,000 aksione me vlerë nominale 12,000 Lekë për aksion. Aksionet zotërohen 100% nga z.Trifon Murataj.

	Nr.Pjeseve	Vlera nominale e aksionit	Struktura	Kapitali i aksionar Lekë
Trifon MURATAJ	2,000.00	12,000.00	100%	24,000,000.00

Rezervat ligjore janë në vlerën 7,819,443 Lekë.

Rezervat e tjera të Shoqërisë janë në vlerën 122,961,077 Lekë .

Fitim/humbja e vitit ushtrimor është në vlerën 88,810,849 Lekë.

11. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Kredi	820,852	-
Leasing	17,659,362	15,616,273
	18,480,213	15,616,273

12. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime

Balanca e granteve të ardhurave të shtyra dhe të tjera detyrimeve më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Grante, te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	-	-
	-	-

13. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Hua Afatshkurter Overdrafte	399,949,839	332,154,778
	399,949,839	332,154,778

14. Llogaritë të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
FURNITORE	536,631,210	408,262,378
	536,631,210	408,262,378



15. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

Detyrime per tatimin aktual	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	1,090,712	926,189
Tatim mbi fitimin	4,088,920	4,948,722
Tatimi në burim	63,914	42,558
Detyrime dhe Rivlersime Tatimore	857,906	857,906
Detyrime nga rivlersime tatimore 1	<u>4,453,031</u>	<u>0</u>
	10,554,483	6,775,375

16. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

Llogari te tjera te pagueshme	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Paga per tu paguar personelit	43,741,334	33,456,928
Detyrime te tjera	<u>2,153,883</u>	<u>2,153,883</u>
	45,895,217	35,610,811

17. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Te ardhura nga shitja e mallrave	4,009,777,163	3,318,209,679
Shitja e punimeve dhe sherbimeve	4,120,506	19,687,798
Te ardhura nga Autofaturimet	13,982,129	15,446,758
Shitje te tjera	731,422	50,905
Te ardhura nga transport per te Trete	<u>20,147,570</u>	<u>50,816,679</u>
	4,048,758,790	3,404,211,819

18. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë për 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit		
Te ardhura te tjera	<u>8,087,944</u>	<u>8,431,877</u>
	8,087,944	8,431,877



19. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 janë si më poshtë :

	31.12.2019
Kostoja e Mallrave dhe Shërbimeve të Shitura	3,690,313,632
	<u>3,690,313,632</u>

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31.12.2019
Pagat Bruto	42,522,002
Kontributet e sig. shoqërore	7,037,589
Shpenzime të tjera për personelin	-
	<u>49,559,591</u>

21. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31.12.2019
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	10,551,423
	<u>10,551,423</u>

22. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë :

	31.12.2019
Materiale ndihmëse	542,758
Karburant	81,622,520
Energji	13,642,659
Qera	15,042,137
Kancelari	2,043,851
Mirembajtje dhe Riparime	18,544,309
Siguracione	3,132,684
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,302,842
Taksa dhe tarifa vendore	2,339,059
Autofaturime për Trajtime të Përgjithshme	13,982,129
Komisione të ndërmjetësve dhe Honorare	1,482,372
Shpenzime për koncesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	137,500
Publicitet, reklama	15,639,442
Transferime, Udhetime, Dieta	20,460,033
Pritje dhe Perfaqesime	1,272,238
Shpenzime për shërbimet bankare	4,104,878
Takse regjistrimi	-
Gjoha dhe demshperblime	616,003
Vlera kontabel e aktive afatgjata të shitura	34,142
Të tjera	10,825,923
	<u>206,767,479</u>



23. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31.12.2019
Te Ardhura/ Shpenzime nga interesat	(15,904,441)
Te Ardura nga Kursi Këmbimit	21,678,569
Të ardhura të tjera financiare	-
	5,774,129

24. Rezultati Tatimore

Përlllogaritja e rezultatit tatimor 2019 paraqitet si më poshtë :

	31.12.2019
Fitimi (Humbja) para Tatimit	105,428,737
Shpenzime te panjohura(Gjoha e Interesa Tatimore)	5,357,182
Shpenzime te panjohura te tjera	-
Humbje e mbartur nga viti kaluar	-
Fitimi (Humbja) Tatimore	110,785,919
Tatimi mbi Fitimin (15%)	(16,617,888)
Fitimi(Humbja) Neto	88,810,849

25. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influence të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

Transaksionet me palët e lidhura Shoqëria ZICO sha nuk ka.

26. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit. Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.



Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e shoqërisë mbartin risk të normave të interesit.

	31.12.2019	31.12.2018
Instrumenta me interes fiks		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	18,480,213	15,616,273
	18,480,213	15,616,273
Instrumenta me interes variabel		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	399,949,839	332,154,778
	399,949,839	332,154,778

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiarë. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 Dhjetor 2019			Total
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	323,777,469	-	-	323,777,469
Shpenzime për tu shperndare	-	-	-	-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	39,289,315	-	-	39,289,315
	363,066,784	-	-	363,066,784
31 Dhjetor 2018				
Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	233,311,110	-	-	233,311,110
Shpenzime për tu shperndare	-	-	-	-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	19,371,048	-	-	19,371,048
	252,682,158	-	-	252,682,158

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.



ZICO SHA viti 2018*(Vlerat janë në Lek)*

31 Dhjetor 2019	Nga 1 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Me shume se 5 vjet	Total
Llogari te arketueshme e te tjera	323,777,469			323,777,469
Shpenzime per tu shperndare	-			-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	39,289,315	-	-	39,289,315
Shuma	363,066,784	-	-	363,066,784
Detyrimet e pagueshme te tjera	(593,080,910)			(593,080,910)
Hua afatgjata (Leasing)		(17,659,362)		(17,659,362)
Hua afatgjata (Kredi)		(820,851.57)		(820,852)
Hua afatshkurtra	(399,949,839)			(399,949,839)
Shuma	(993,030,749)	(18,480,213.14)	-	(1,011,510,962)
Rreziku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2019	(629,963,965)	(18,480,213.14)	-	(648,444,178)

31 Dhjetor 2018	Nga 1 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Me shume se 5 vjet	Total
Llogari te arketueshme e te tjera	233,311,110			233,311,110
Shpenzime per tu shperndare	-			-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	19,371,048	-	-	19,371,048
Shuma	252,682,158	-	-	252,682,158
Detyrime te pagueshme e te tjera	(450,648,564)			(450,648,564)
Hua afatgjata (Leasing)		(15,616,274)		(15,616,274)
Hua afatgjata (Kredi)		-		-
Hua afatshkurter	(332,154,778)			(332,154,778)
Shuma	(782,803,342)	(15,616,274)	-	(798,419,616)
Rreziku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2018	(530,121,184)	(15,616,274.00)	-	(545,737,458)

27. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiare perfshijne aktivet dhe detyrimet financiare. Aktivet financiare perbehen nga gjendja e llogarive ne bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare perbehen nga të pagueshmet. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare perfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta te të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përfaqësojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

28. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Pas datës 31.12.2019 shoqëria nuk ka veprime që mund të ndikojne në rezultatin e vitit financiar.

Trifon MURATAJ
Administrator i ZICO SHA



Desantila PRRENJASI
Hartuese e Pasqyrave Financiare